

FJALA E DEPUTETES ETILDA GJONAJ

E ENJTE 17 MARS 2022

E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Jemi të gjithë në një mendje që sot më shumë se kurrë është e qartë domosdoshmëria jetike e perspektivës europiane të Ballkanit Perëndimor dhe përballja me influencat apo tendencat joperëndimore. Agresioni rus ndaj Ukrainës ka tronditur të gjithë kontinentin dhe na ka kujtuar se BE-ja nuk është vetëm një zonë e prosperitetit ekonomik dhe e vlerave demokratike, por edhe një zonë gjeopolitike e sigurisë, e krijuar që në gjenezë mbi bazën e dy parimeve thelbësore: paqes dhe solidaritetit.

Në këto ditë të vështira Polonia, Sllovakia dhe vendet fqinje po tregojnë solidaritet të pakrahasueshëm me mikpritjen e më shumë se 3 milionë refugjatëve ukrainas, ashtu si Shqipëria e ka treguar që ka mbajtur të njëjtin qëndrim me të gjithë partnerët europianë dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, duke dënuar kështu agresionin rus. Rezoluta e miratuar prej disa ditësh nga ky Kuvend, roli aktiv i Shqipërisë në Këshillin e Sigurisë, si penëmbajtës i draftrezolutës të miratuar nga Asambleja e Kombeve të Bashkuara, dhe së fundi bashkimi i votës sonë për përjashtimin e Ruisë nga Këshilli i Europës në Asambleenë Parlamentare, tregojnë qartësisht vendosmërinë e Shqipërisë për të dënuar agresionin dhe sulmet e Ruisë ndaj Ukrainës. Ishte trishtuese të shihje heqjen e flamurit rus nga 47 flamujt e vendeve anëtare të Këshillit të Europës, por është e vetmja përgjigje për të mbrojtur vlerat e demokracisë së shteteve, të drejtat e njeriut dhe, njëkohësisht, atë çfarë përbën në vetvete Këshilli i Europës. Për të shprehur solidaritetin si një aleat i denjë me të gjitha shtetet e tjera, Shqipëria ka ndarë me vendimmarrjet dhe me qëndrimet e saj të njëjtat vlera të demokracisë dhe sovranitetit. BE-ja është një zonë sigurie dhe paqeje, kështu që është shumë e rëndësishme që procesi i integritit për Shqipërinë dhe për vendet e Ballkanit Perëndimor të përshpejtohet.

Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut e meritojnë të kenë një përgjigje sa më të shpejtë për këtë proces, me caktim e datës së Konferencës së parë Ndërqeveritare dhe ky është momenti, kur Bashkimi Europian duhet të tregojë me veprime konkrete vlerat e krijimit të tij. Perspektiva dhe agjenda europiane e Shqipërisë vazhdon qartësisht të qëndrojë në krye të prioriteteve të qeverisë dhe të Kuvendit, kështu që të gjithë së bashku, pa dallim përkatësie politike, duhet të mbështesim këtë proces me veprime konkrete. Në fakt, përkundër asaj që dëgjojmë brenda nesh, edhe në këtë Kuvend, nga disa kolegë të opozitës, jashtë nesh në Bruksel apo në parlamente të vendeve të tjera europiane, është e qartë që vendi ynë i ka plotësuar të gjitha kriteret për hapin e radhës, atë të mbajtjes së Konferencës së parë Ndërqeveritare. I njëjti mesazh i qartë vjen edhe nga kolegët tanë në Bundestag, me të cilët patëm mundësi të shkëmbejmë diskutime këto ditë në Berlin.

Përfaqësues të të gjithë spektrit politik të ESPD-së, CDU-së, CSU-së, por dhe të Gjellbërit mbështesin dhe do të vijojnë të shtyjnë përpara mbajtjen e Konferencës së Parë Ndërqeveritare për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut, duke e konsideruar atë si një vendim të vonuar të Bashkimit European. Avancimi i këtij procesi, sigurisht, do të na vërë përpara sfidave të reja, por jam e bindur se me të njëjtën vendosmëri siç çuam përpara reformën në drejtësi, do të mundemi të përparojmë me detyrimet që do të lindin në vijim për këtë proces. Rezultatet e reformës në drejtësi jo vetëm janë të njohura nga ne apo nga partnerët tanë ndërkombëtarë, por në fakt reforma shikohet sot si një model, që mendohet të merret dhe të huazohet nga disa vende të tjera, të cilat janë aspiruese të Bashkimit European. Njëkohësisht, dua të theksoj edhe për atë çka u diskutua më herët nga kolegët deputetë, reforma në drejtësi dhe rezultatet e saj kanë qenë karta kryesore e të gjithë avancimit në procesin e integritit european. Përfshirja e opozitës në këtë proces për sa i përket integritit european të Shqipërisë është konsideruar e rëndësishme dhe jo pa qëllim i është lënë opozitës, siç ka qenë tradita, drejtimi i organeve të Këshillit Kombëtar për Integrimin European dhe Komisionin i Integritit European, pra me qëllim që në agjendën e procesit integrues të vendit, të jemi të gjithë aktorët politikë së bashku.

Roli i organeve të Kuvendit, si i Këshillit Kombëtar për Integrimin European dhe Komisionit për Integrimin European, është shumë i rëndësishëm dhe për vite të tëra kanë dhënë një kontribut domethënës në mbështetjen dhe në avancimin e agjendës europiane të vendit. Besojmë se jo vetëm që duhet të jemi bashkë, i gjithë spektri politik, por edhe shoqëria civile, të rinjtë, partnerët europianë, për të qenë pjesë e agjendës së veprimtarisë së Këshillit Kombëtar dhe Komisionit të Integritit. Gjithëpërfshirja dhe transparenca janë thelbësore për progresin e qëndrueshëm të Shqipërisë në procesin e integritit european, ashtu siç rezultoi edhe nga ky raport që po diskutojmë sot dhe që pret miratimin me votat tona. Ndaj Këshillit Kombëtar i Integritit European duhet të vijojë punën për të forcuar bashkëpunimin me shoqërinë civile, institucionet shtetërore dhe partnerët tanë ndërkombëtarë, me qëllim përmirësimin cilësor të monitorimit të procesit të integritit european.

Ftoj kolegët e Këshillit Kombëtar të Integritit European të forcojnë më tej rolin e tyre, si një forum kombëtar, për ta konsideruar këtë këshill gjithëpërfshirës, si dhe për të nxitur më shumë bashkëpunimin ndërmjet aktorëve e politikë vendas, po pse jo, edhe të homologëve në parlamentet e vendeve europiane. Është e nevojshme, gjithashtu, nga ne aktorët politikë, nëpërmjet komisioneve apo të gjitha organeve të Kuvendit, një përfshirje më efektive e të rinjve dhe qytetarëve në të gjitha nivelet e pjesëmarrjes, atje ku ndodhen ata, jo vetëm për rritjen e transparencës së këtij procesi, por dhe për vlerën që japin në rritjen e besimit të qytetarëve në procesin e integritit evropian, si një ndër prioritete e panegociueshme për Shqipërinë. Faleminderit!